**VENDIM**
**Nr. 263, datë 21.10.2025**

**MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN NËPËRMJET VENDOSJES SË BARRËS SIGURUESE TË ASETEVE FIKSE TË SHOQËRISË "ERSEKA SOLAR PARK 1" SHPK**

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa "a", dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 4, germat "a" dhe "b", 7 dhe 8, të "Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.7.2016; të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 193, datë 12.8.2025, "Mbi procedurën e trajtimit të kërkesave të të licencuarve të cilët plotësojnë kriteret ligjore për marrjen e autorizimit nga ERE, për transferim asetesh në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, që në fazën e parë të aplikimit"; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe pikës 1.3 dhe pikës 1.6, të "Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.10.2025, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 2573/3 prot., datë 17.10.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve "Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë 'Erseka Solar Park 1' sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet marrëveshjes siguruese) të aseteve fikse të saj",

konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënien e autorizimit për shoqërinë "Erseka Solar Park 1" sh.p.k. është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

- Shoqëria "Erseka Solar Park 1" sh.p.k. është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 176, datë 18.5.2023, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet 20 mw, në Njësinë Administrative të Qendrës Ersekë, Bashkia Kolonjë, qarku Korçë.

- Me shkresën me nr. 2573 prot., datë 3.10.2025, shoqëria ka paraqitur kërkesën për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosje kolateral asetet e të licencuarit "Erseka Solar Park 1" sh.p.k., si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimeve ndaj Banka e Parë e Investimeve – Albania sh.a. dhe First Investment Bank AD, Sofie Bullgari, ku agjent i kredisë është zgjedhur Banka e Parë e Investimeve – Albania sh.a.

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe dokumentacionit të paraqitur

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, si dhe të neneve 2, germa "a", 3, 5, germa "j" dhe 6, të "Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, rezulton se ERE miraton kërkesat e të licencuarave për transferimin e aseteve fikse (të paluajtshme) që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në mbështetje të përcaktimeve të nenit 7, të "Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit", rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin/informacionin e kërkuar.

3. Plotësimi i kërkesës sipas nenit 7:

- pika 1 – janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara mbi kërkesën për transferim, ndër të tjera si më poshtë vijon:

- germa "a" – është depozituar ekstrakti historik i shoqërisë, i vlefshëm brenda afatit ligjor;

- germa "b" – është plotësuar informacioni mbi veprimtarinë e licencuar;

- germa "c" – është plotësuar informacioni mbi gjendjen financiare të kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efekti i pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve;

- germa "d" – është bërë një përshkrim i kandidatit;

- germat: "e", "f" dhe "g" – arsyet e kërkesës, efektet në aktivitetin e licencuar dhe furnizimin e klientëve;

- germa "h" – janë depozituar marrëveshjet përkatëse;

- *kontratë kredie 3298 rep., nr. 1375 kol., datë 1.10.2025, nënshkruar nga palët;*

- *-marrëveshje siguruese nr. 3302 rep., nr. 1379 kol., datë 1.10.2025, të nënshkruar nga palët;*

- *kontratën e bashkëpunimit, me nr. 615 rep., nr. 465 kol., datë 6.2.2023, të ndryshuar.*

- germa "i" – deklarata e kredidhënësit për garantimin e vazhdimësisë së aktivitetit;

- germa "j" – deklarata dhe vërtetimi për mungesë transferimesh të mëparshme mbi asetet fikse;

- pika 3 – është plotësuar informacioni i kërkuar në këtë pikë që lidhet me detyrimet me të cilat ngarkohet subjekti për shkak të marrëveshjes së koncesionit në pjesët që transferojnë te përfituesi përfshirë edhe informimin e Autoriteti Shtetëror, në lidhje me qëllimin e transferimit të aseteve;

- pika 4 – kërkesa për aplikim është nënshkruar nga administratori i shoqërisë, ndërsa dokumentet e tjera shoqëruese të këtij aplikimi janë nënshkruar nga administratori dhe/ose personat e autorizuar sipas rastit;

- pika 6 – shoqëria ka bërë me dije se kërkon të mos jenë të hapura për publikim, për arsye konkurrence, marrëveshja siguruese nr. 3302 rep., nr. 1379 kol., datë 1.10.2025. Megjithatë, vlerësohet se, për arsye ligjore dhe në përputhje me parimin e transparencës së vendimmarrjes publike, disa nga këto elemente, si identiteti i kredidhënësve dhe lista e aseteve objekt i barrës, janë thelbësore për përmbajtjen e aktit administrativ dhe nuk mund të përjashtohen nga publikimi. Për rrjedhojë, lista e aseteve, duke qenë pjesë përbërëse e vendimit të ERE-s, publikohet së bashku me vendimin përkatës, ndërsa për pjesën tjetër të dokumentacionit do të mbahet në konsideratë konfidencialiteti i tyre nga ana e ERE-s.

- Referuar vendimit të Bordit të ERE-s nr. 193, datë 12.8.2025, ku citohet se për të licencuarit që aplikojnë për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese) të aseteve fikse, dhe që kanë plotësuar gjithë dokumentacionin e kërkuar nga "Rregullorja e procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, që në fazën e parë të aplikimit, Bordi i ERE-s do të shprehet mbi kërkesën për dhënie autorizimi për transferim aseti brenda 45 ditëve nga aplikimi.

4. Kushtet e vendosura për dhënien e autorizimit

- Dhënia e autorizimit nga ERE nuk e çliron shoqërinë nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve/institucioneve të tjera apo palëve të treta për këtë transferim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe/institucione.

- Përveç sa më sipër, për shkak të natyrës që ka vendosja e një mjeti të tillë mbi asetet e shoqërisë për garantimin e detyrimit përkatës nga i licencuari, vlerësohet që t'i lihet kusht shoqërisë që të njoftojë menjëherë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi asetet e saj ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese) të aseteve fikse të shoqërisë "Erseka Solar Park 1" sh.p.k., si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj "Banka e Parë e Investimeve – Albania" sh.a. dhe "First Investment Bank AD" sh.a., ku agjent i kredisë është zgjedhur Banka e Parë e Investimeve – Albania sh.a., që rrjedhin nga kontrata e kredisë nr. 3298 rep., nr. 1375 kol., datë 1.10.2025 dhe nga marrëveshja siguruese nr. 3302 rep., nr. 1379 kol, datë 1.10.2025 (lista e aseteve bashkëlidhur).

2. Dhënia e autorizimit sipas përcaktimeve të pikës 1 nuk e çliron shoqërinë "Erseka Solar Park 1" sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

3. Shoqëria "Erseka Solar Park 1" sh.p.k. të njoftojë menjëherë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi asetet e paluajtshme të saj që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm, si dhe në rast të çdo ndryshimi në këtë marrëveshje, përfshirë transferimin tek të tretët.

4. Ky vendim është objekt rishikimi në rast se shoqëria dokumenton heqjen e barrës siguruese të radhës së parë të vendosur mbi asetet e saj apo depozitohet ndonjë dokument i ndryshëm nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë "Erseka Solar Park 1" sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Petrit Ahmeti**

## "LISTA MAKINERI PAJISJE E SHOQËRISË "ERSEKA SOLAR PARK 1" SH.P.K.

1. Panele fotovoltaike, shtesë vlerë aseti, *me vlerë 299,278,740.50 lekë;*
2. Auger – Pajisje shpimi + Pjesë shtesë, *me vlerë 1,515,698.40 lekë;*
3. Trakti Hyrës 110 kV në N/S Ersekë, *me vlerë 25,447,766.54 lekë;*
4. Linja elektrike 110 kV 3.7 km, *me vlerë 40,954,361.00 lekë;*
5. Trakti hyrës 110 kV i linjës N/S Starje-Ersekë, *me vlerë 10,916,568.94 lekë;*
6. Zbarat 110 kV N/St Ersekë, *me vlerë 3,062,487.31 lekë;*
7. Trakti 110 kV i Transformatorit të Fuqisë, *me vlerë 8,131,699.05 lekë;*
8. Sistemi i mbrojtjes, komandimit, kontrollit, sistemit SCADA, *me vlerë 62,232,851.45 lekë;*
9. Transformator Elektrik Jupiter 6000-K-H1, *me vlerë 48,173,107.81 lekë;*
10. Panele Diellore Fotovoltaike, *me vlerë 374,231,733.12 lekë;*
11. Struktura Konstruksione Metalike, *me vlerë 196,226,214.33 lekë;*
12. Invertera HUAWEI SUN2000-330KTL-H1, *me vlerë 58,455,820.50 lekë;*
13. Invertera HUAWEI SUN2000-330KTL-H1, *me vlerë 3,025,881.78 lekë;*
14. Pjesë të konstruksioneve metalike, *me vlerë 625,820.05 lekë;*
15. Struktura, shtesë vlerë aseti, *me vlerë 45,696,143.12 lekë;*
16. Transformator Elektrik JUPITER 6000-50kVA, *me vlerë 16,576,245.60 lekë;*
17. Transformator POWER 110/20kV, 40/50 MVA, *me vlerë 45,661,781.44 lekë;*
18. Cela Elektrike 20 KV (7 copë), *me vlerë 20,705,230.20 lekë;*
19. FV Sistem Telekomunikacioni, *me vlerë 2,456,500.00 lekë;*
20. Panele Diellore, *me vlerë 12,580,104.04 lekë;*
21. Boks Komunikimi SCADA, *me vlerë 4,480,156.49 lekë;*
22. Aparat Meteorologjik, *me vlerë 16,607,709.76 lekë;*
23. Aparat Meteorologjik SIEMENS, *me vlerë 4,344,709.60 lekë;*
24. Konvertitorë, *me vlerë 1,840,971.78 lekë;*

25. Panel SCADA, *me vlerë 5,772,669.99 lekë;*
26. Aparat Kontrolli për Impiante Fotovoltaike 237768.38, *me vlerë 951,073.55 lekë;*
27. Bulloneri, *me vlerë 867,604.54 lekë;*
28. Matës Energjie MK6ES 206700.4, *me vlerë 413,400.80 lekë;*
29. Transformator Fuqie 50-200KVA 1750000, *me vlerë 175,000.00 lekë.*

***Vlera totale rezulton 1,311,408,051.67 (një miliard e treqind e njëmbëdhjetë milion e katërqind e tetë mijë e pesëdhjetë e një pikë gjashtëdhjetë e shtatë) lekë.***